



Arrestohet i dyshuari që gjuajti me armë zyrtarin policor në Pejë



17/12/2024 19:55

f

t

l

Sot me datë 17.12.2024, rreth orës 16:03, deri sa zyrtari Policor ishte duke kaluar zebrat në rrugën “ Mbreteresha Teutë”, “Përball Policisë”, ka ardhur një veturë me targa vendore, duke tentuar ta godas me automjet zyrtarin Policor, zyrtari Policor iu është shmangur goditjes nga kjo veturë, i dyshuari gjatë levizjës nga dritarja e automjetit ka shtënë me armë zjarri dy (2) herë në drejtim të zyrtarit Policor, mirëpo fatmirësisht zyrtari Policor nuk është lënduar nga këto të shtëna. Personi i dyshuar është larguar me shpejtësi të madhe me veturën ne fjalë.

Siç ka njoftuar Policia, ata menjëherë kanë reaguar mes tjerash ka bërë sigurimin e vendit të ngjarjës, aty janë gjetur dhe sekuestruar dy (2) gëzhjoja të kalibrit 7.65mm.

Stafi menagjues i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë, hetuesit e Sektorit Rajonal për Hetime, Hetuesit e Stacionit Policor në Pejë, Njësia për reagim të shpejtë dhe njësi tjera përkatëse, janë vënë në kërkim të personit të dyshuar, pas një pune intensive operativo-hetimore, mes tjerash janë realizuar tri (3) bastisje në lokacione të ndryshme. Rreth orës 18:25, është arritur te arrestohet i dyshuari i këtij rasti, është sekuestruar arma e cila dyshohet që është përdor në rast, po ashtu është sekuestruar edhe vetura e cila është përdorur në rast.

Të gjitha veprimet janë marrë ne koordinim me Prokurorin e shtetit, i dyshuari pas intervistimit me vendim te Prokurorit të shëtit është dërguar në mbajtje për 48-orë, ndërsa rasti cilësohet “Vrasje e Rëndë në Tentativë” dhe “ Mbajtje në Pronësi, Kontroll ose Posedim i Paautorizuar i Armëve”.

Më shumë nga uebi

Buci dhe Santiana nuk mund të distancohen, përsëri

Nëse ai i bën këto gjëra, ju do me të vërtetë

Rrjedh uji, dëmtohen disa zyre në Kuvendin e Kosovës

Bëhet virale një video e BBVA ku shihen disa persona

Violeta Kukaj ia kalon edhe vajzës së saj, del e veshur e

nativeGRAM

by LuponMedia

Artikuj të ngjashëm

lajmi.net

December 17, 2024

“Yrnekun e keq e ka VV-ja” – Berisha: Populli duhet të...

lajmi.net

December 17, 2024

Vrasja e Ibush Kllokoqit, eksperti i psikiatrisë konstaton se i akuzuari...

lajmi.net

December 17, 2024

Dy ferizajas rrëmbyen një person në Pejë dhe e dërguan në...